



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2909/ 12 prot.

Datë 14/11/2025

V E N D I M

Nr. 1683/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro
Anila Malaj
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Anëtar
Anëtar

Në mbledhjen e datës 14/11/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1582/2025, datë 03.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLLOJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)..

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALB-MATRIX GROUP” SHPK me NIPT: L91616027G, dhe me adresë: *Rruga "Isa Boletini" shk.9 /1/A3 / Privat, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto” Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1582/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLLOJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK”, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALB MATRIX GROUP” SHPK*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..

I.2. Me shkresën nr. 5312/2 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2909/7 prot, datë 12.11.2025, autoriteti kontraktor KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare), lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1582/2025, datë 03.11.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë

“ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLGJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 5312/2 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2909/7 prot, datë 12.11.2025, autoriteti kontraktor KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare), lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1582/2025, datë 03.11.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar ofertën e bashkimit të opeatorëve ekonomikë “ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLGJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe verifikimeve të bëra në systemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke skualifikuar ofertën e bashkimit të opeatorëve ekonomikë “ALB MATRIX GROUP SHPK & SURVEY SOLUTION SHPK” në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1582/2025, datë 03.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61965-09-18-2025, me objekt: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLGJIK PRANË TYRE”, me fond limit 6.600.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

